

BACHELOR NË “ARTE SKENIKE”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Arte Skenike” ka për qëllim të zhvillojë aftësitë krijuese, teknike dhe interpretuese të studentëve në fushat e aktrimit, regjisë dhe baletit. Programi synon të pajisë studentët me aftësitë e nevojshme teknike për realizimin e shfaqjeve në skenë, përfshirë përdorimin e skenografisë, dritës, zërit, e teknologjive skenike. Studentët përgatiten për të punuar në teatër, kompani artistike, studio produksioni, dhe për të kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe artit skenik brenda vendit dhe në mjedise ndërkombëtare.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të këtij programi, studenti do të:

- Interpretojë vepra dhe krijimtari teatrale dhe kinematografike shqiptare dhe ndërkombëtare.
- Shpalosë aftësi të performancës skenike për të marrë rol interpretues në shfaqjet e improvizuara dhe të planifikuara dhe t'i përdorë këto aftësi për të eksploruar dhe komunikuar mendime, ide, përvoja dhe ndjenja;
- Përvetësojë teknikat e dizajnit të skenës dhe ndriçimit për të krijuar efektet e dëshiruara dhe për të përmirësuar përvojën e shikuesit dhe performuesit;
- Kuptojë dhe aplikojë parimet etike në krijimin dhe performancën e veprave artistike, duke siguruar profesionalizëm në kontekstet e ndryshme të performancës.
- Kryejë analiza dhe ekspertiza në fushat që lidhen me artet skenike dhe kinematografike.
- Demonstrtojë aftësi të mendimit kritik dhe reflektimit në vlerësimin e veprave dhe shfaqjeve artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Krijojë performanca ndërdisiplinore që përfshijnë elementë të ndryshëm të artit si muzika, baleti, multimedia dhe arti vizual.

PROFILI “REGJI”

- Zotërojë njohuri të konsoliduara dhe të thelluara për krijimin, organizimin, vënien në skenë dhe produksionin e një performance artistike, skenike, filmike e televizive;
- Drejtojë ekipin artistik dhe atë teknik në realizimin veprave nga krijimtaria shqiptare dhe e huaj, edhe nëpërmjet bashkëprodhimeve të ndërsjella.
- Zhvillojë aftësi të organizimit dhe menaxhimit të shfaqjeve teatrale dhe eventeve kulturore, përfshirë marketingun dhe promovimin e tyre.
- Komunikojë dhe bashkëpunojë në mënyrë profesionale me aktorë, regjisorë, dizajnues dhe profesionistë të tjerë të një produksioni skenik, filmik, televiziv për të krijuar një performancë koherente.

PROFILI “AKTRIM”

- Analizojë kërkesat përmbajtësore dhe teknike bazë të një produksioni artistik.
- Luajë në skena teatrore së bashku me trupat profesioniste në fushën e interpretimit skenik.
- Komunikojë dhe ndërveprojë në mënyrë profesionale me kolegët e një produksioni skenik, kinematografik dhe televiziv edhe më gjerë.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Me mbarimin e studimeve, studenti mund të punësohet si:

- Regjisor filmi/teatri/TV
- Editor filmi/video
- Aktor filmi/teatri
- Asistent regjisor filmi/teatri/TV.
- Prezantues/Drejtues i programeve apo projekteve specifike, spektakleve të realizuara në mediumet TV, radio, internet.
- Koordinator i produksionit televiziv.
- Kritik arti në fushën e arteve skenike
- Gazetar i programeve specifike ose i rubrikës së artit dhe kulturës.
- Specialist në institucione qendrore apo vendore të artit dhe kulturës
- Ekspert/koordinator në projekte kulturore dhe artistike kombëtare dhe ndërkombëtare.



BACHELOR "ARTE SKENIKE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15% - 20%/ 32 ECTS

1	III	1	Hyrje në Filozofi	6
2	I	2	Shkrim Akademik dhe Metoda kërkimi	8
3	II	1	Hyrje në Komunikim	6
4	I	1	Hyrje në Sociologji	6
5	I	1	Hyrje në Psikologji	6
				32

B - LËNDË KARAKTERIZUESE/ 50% - 55%/ 94 ECTS

1	I	1+2	Lëvizje skenike	10
2	I	1	Histori e arteve skenike	6
3	I	2	Fotografia	6
4	II	2	Estetikë	6
5	II	1	Komunikim Ndërkulturor	6
6	III	1	Teknikat e Skenarit	6
7	II	2	Skenografia	8
8	II	1	Bazat e Semiotikës	6
9	II	2	Zhanret Letrare	6
10	II	2	Drama, komedia dhe performanca klasike	8
11	III	1	Reklama	6
12	III	1	Bazat e Produksionit muzikor	6
13	III	2	Bazat e Produksionit	8
14	III	2	Teknikat e ndriçimit	6
				94

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE/ 12% - 15%/ 27 ECTS

PROFIL I			AKTRIM	
1	I	1+2	Aktrim I + II	9
2	II	1+2	Aktrim III	9
3	III	1	Aktrim IV	4
4	II	1	Bazat e Kantos I	5
PROFIL II			REGJI	
1	I	1+2	Hyrje në regji + Regji 2	11
2	II	1	Regji 3	6
3	II	2	Regji në studio	6
4	III	1	Teknologji post-produksioni	4
				27

D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 15%/ 20 ECTS

1	I	2	Anglisht	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	II	2	Hartim dhe menaxhim projektesh	6
4	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				20

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provim i Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	--	---

TOTALI 180